



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e gjashtë e rregullt e Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: **26.10.2020** (e hënë) duke filluar në ora **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-se;
2. Aprovimi i planit Aksional Komunal për të zhvendosur dhe kthim të qendrueshëm;
3. Aprovimi i propozim vendimit për shfrytëzimin e mjeteve të ndara nga MAPL;
4. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 19.10.2020
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

(4. Arsic)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 29.09.2020, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Selatin Nuhii, Dobrivoje Djordjevic, Jorgovanka Filic, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Ivica Cenic, Predrag Stojkovic, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, zyrtar komunal dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojmë mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i propozim buxhetit për vitin 2021-2023;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti antarët e Kuvendit se a pajtoheni me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Pasi nuk pati propozime aprovohet rendi i ditës me 14 vota për dhe 1 nuk ka votuar nga antarët prezent të Kuvendit.

Kryesuesi tha: fillimisht ju kerkoj falje qe e kemi ndrruar daten e mbledhjes pasi që ka qenë e parapar për neser por për asrye të aprovimit të buxhetit dhe me kerkes të Drejtoris së Financave kemi vendosur që ta mbaj sot.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali me 14 vota për dhe 1 nuk ka votuar.

Pika e dytë: Aprovimi i propozim buxhetit për vitin 2021-2023;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalen Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi pershendeti të pranishmit tha: në bazë të kornizes që kemi marrë nga Ministria e Financave e kemi pregadit edhe buxhetin për vitin 2021/23 i cili në total është 2,808.423,grandi qeveritar janë 2,585,487 ndersa nga të hyrat vetanake 222,936€. Nga buxheti total për paga dhe meditje janë 2,106,144€, për mallra dhe sherbime janë 303,335€, për shpenzime komunale janë 69,259€, për subvencione janë 49,521€ dhe për investime kapitale janë 280,164€, i keni në tabela të ndara në secilen kategori dhe për secilen drejtori, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: mendoj se kjo seancë për aprovim të buxhetit është një prej seancave më të rëndësishme, në procedura normale duhet të jetë prezent edhe Kryetari i Komunës që ta harmonizojmë buxhetin paraprakisht. Andaj unë si zv.kryesues i kuvendit në bashkpunim me shumicën e antrëve të Kuvendit propozoj që ky propozim buxhet të ndryshohet. Propozoj që të kodi i Kryetarit për mallra dhe shërbime që janë 28,335€ të tehiqen 5,000€ dhe ti mbesin Kryetarit 23,335€ mallra dhe shërbime nga grandit qeveritar dhe të barten në Kuvend të bëhen 13,000€. Të grandit për subvencione në sektor të bujqësisë, Kryetari i ka propozuar 33,736€ nga grandit qeveritar dhe propozoj që kjo shumë të bartet në shpenzime komunale dhe të subvencionet të mbesin vetëm të mjetet nga të hyrat vetanake pasi që ka mjete të mjaftueshme. Edhe këto mjete që barten në komunalë ju kthehen qytetarëve pasi që ka shumë obligime pa paguar si rrym, mbeturina, ujë dhe nga ajo shumë prej 33,736€ të barten 10,000€ në shëndetësi dhe arsim, dmth të kodi i subvencioneve të mbeten vetëm mjetet nga grandit qeveritar ndërsa nga të hyrat vetanake të barten në komunalë. Kalojmë të lista e projekteve, kodi për mirëmbajtje të rrugës ka qenë i paraparë 29,421€ por nuk po e dim se cilat rrugë po mirëmbahen andaj propozoj që ky kod për mirëmbajtje të rrugës të jetë 4,400€ dhe kodi për mirëmbajtje të trotuareve të jetë 5,000€, kod për kanalizim nuk ka por kërkoj që të jetë një kod për ndërtim të kanalizimeve në vlerë prej 15,000€, mirëmbajtja e ndriqimit publik këtu është gabim pasi që duhet të jetë kod vetëm për ndriqimi publik. Të investimet kapitale të materiali ndërtimor mos të ndahet buxhet nga grandit qeveritar por vetëm nga të hyrat vetanake. Të asfaltimi i rrugëve duhet të jenë 129,000€, ky është propozimi im në bashkpunim me shumicën e antarëve të Kuvendit.

Sercan Todorovic tha: zv.Kryesuesi dhe shumë propozime do të mundohem të pergjigjem në disa mënyra prej tyre, sa i përket subvencioneve nuk mund të ndryshojmë pasi që Ministria e Financave i ka nda kështu dhe nuk mund të barten në tjera kode e as në shpenzime komunale. Të investimet kapitale, ndriqimi publik duhet të jetë së bashku me mirëmbajtje pasi që nëse nuk mirëmbahet nuk funksionon ndriqimi, kemi shumë fshatrat që ndriqimi është por jofunksional pasi që dritat nuk punojnë për këtë arsye duhet të jetë edhe mirëmbajtja. Nuk kemi mundësi që të realizohen ashtu projektet si vitin e kaluar p.sh keni propozuar 10 rrugë por mjete ka pasur vetëm për 5 rrugë duhet shikuar si është buxheti si janë mundësit që të realizohen. E kemi propozim buxhetin nga Kryetari dhe kërkoj nga ju që ta aprovi. Ramush Mehmeti tha: e kuptoj Drejtorin e Financave pasi që e mbron propozimin e Kryetarit, por duhet ta kuptoj edhe rolin e Kuvendit pasi që Kuvendi duhet të aprovoj buxhetin ashtu siç don e jo si i propozohet, unë e di se ku kemi mundësi kemi mundësi me të ndryshme ku skem mundësi skem, unë e dhash propozimin nëse kalon në rregull, nëse nuk kalon so problem.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: para se të hudhen në votim propozimet e zv.Kryesuesit kërkoj që të bëhet votimi për secilin kod e jo të votohet përnjëherë i gjithë ndryshimi i propozim buxhetit, si dhe nëse kemi zyrtarë për financa ju lus për më shumë sqarim pasi që në jemi asambleistat duhet të diem se a kemi të drejtë të bëjmë këto transfere apo jo dhe ku kemi mundësi të bartim e jo vetëm pse jemi Kuvend të bëjmë qfarë duam. E dim se qeverisja ndahet në legjislativ edhe egzekutiv, i kemi disa kompetenca në por disa i ka edhe Kryetari dhe aty ku nuk mundemi me nderhy nuk mundemi është diçka që nuk egziston mundësia, ju faleminderit.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: i kam edhe unë vërejtjet e mia për arsye se nuk mirret asnjëherë parasysh aprovimi i buxhetit dhe në mbledhje nuk i kemi prezent as Kryetarin as Nënkryetarin por vetëm drejtorin i cili është i obliguar që të jetë prezent këtu. Është fakt se në bashkërisht me Ramushin dhe një pjesë të opozitës e kemi hartuar disa propozime. E vetmja që unë nuk mundem me u pajtu është të subvencionet dhe të materialet ndërtimore për arsye se vitin e parë kur kam qenë asambleist kam votuar kundër materialit ndërtimor dhe kam pas shumë thirrje prej qytetarëve të cilët më kanë akuzuar se si unë i kam lënë pa shtëpi, kjo e di se ka qenë edhe si propagant prej personave të pushtetit, prandaj edhe nuk do të votoj pasi që nuk jam për me ndalë materialin ndërtimor. Tjetra është të subvencionet në bujqësi, dihet se në jemi komunë rurale dhe 90% e fshatrave mirret me bujqësi dhe e vetmja mënyrë që ata mos të braktisin fshatrat e tyre është subvencionimi në bujqësi, ndoshta ka keqpërdorime por kemi mundësi ligjore që të

kerkojm listen e ndarjes se subvencioneve. Për të gjitha pajtohem, për alokime te mirëmbajtja, ndriqimi e shumë propozime tjera që i kemi bisedu bashkarisht ku mendoj se janë propozime tmira edhe për qytetarët. Dua të jem i qartë se nuk jam për me i terhek materialin ndertimor dhe subvencionet, pasi që jam këtu për qytetarët dhe qytetarët më kan sjell deri këtu, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: këto mjete nuk mundë ti bartim prej Subvencioneve në Komunalit dhe as prej mallrave dhe shërbime në kode tjera.

Ramush Mehmeti tha: ne vetem po kerkojm që buxheti nga grandit qeveritar mu bart ndërsa buxheti nga të hyrat vetanake të mbetet ashtu siç është, për të hyrat vetanake në marrim vendim ndërsa mjetet nga granti qeveritar jam për mos mi keqpërdor.

Sercan Todorovic tha: nese i planifikojm të hyrat vetanake ne mundë të mbesim pa subvencione nuk do të thot se të gjitha mjetet ashtu siç planifikohen realizohen.

Abdyl Gashi tha: i kuptoj shqetësimet tuaja por në të gjitha projektet mundë të vjedhet si në ndriqim ashtu edhe në asfaltim si në cilësi, gjatësi e gjersi, është e njëjta situat si prej materialit ndertimor të barten diku tjetër nese është keqpërdoruese është keqpërdoruese edhe ne ndriqim e asfaltim është e njëjta metod.

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: i kam disa vërejtje, po më intereson ai plani që ishte për bartje të mjeteve e keni aprovuar, çka po ndani tash i keni ndar më herët për ndriqim publik 27,000€ ndërsa për ambulancat vetem 2,000€, çka ka ndryshuar për 15 ditë apo po votoni ju ashtu si po ju pershtate juve.

Ramush Mehmeti tha: ne për të hartuar listen e projekteve duhet së pari të aprovojm buxhetin, ne nuk mundë të bëjm shumë vendime, një vendim është ndryshimi i propozimit, nuk mundë të propozojm list të vendimeve përderisa nuk e kemi ne aprovimin e buxhetit, së pari duhet të aprovohet të ndahet buxheti e pastaj lista e projekteve.

Xhejlane Behluli tha: vetem të mos bëjm një vendim e pastaj të kthehet nga MAPL-ja për munges të legjislatures, e kemi një zyrtarë që ka më shumë informacione si herën e kaluar që na prezantoi se ku kemi të drejt të barten dhe ku nuk kemi të drejt

Sercan Todorovic tha: kerkoj që ti ipet fjala Driton Mustafës për disa sqarime shites.

Kryesuesi ja dha fjalën Driton Mustafes.

Driton Mustafa pasi pershendeti të pranishmit tha: unë u detyrova me marr fjalën për arsye me i dhënë disa sqarime, siç e potencuan disa antarë të Kuvendit se vendimet lehtë mirren por vështirë zbatohen. Unë kam marr pjesë në hartim të buxhetit qysh nga viti 2009 si zyrtarë financiar edhe pse nuk jam tash në atë pozit, jam akter që marr pjesë në hartim të buxhetit. Këto mjete në vlerë prej 2,808,423€ ndahen me qarkore buxhetore, e kjo qarkore buxhetore neve na është ndarë si mangësi për arsye të mosaprovimit të KAB të cilën e kemi pasur në qershor e pastaj është dhurë të dërgohet në Ministri të Financave kjo pasqyr e buxhetit se si po e ndajm ne, ne atë nuk e kemi aprovuar dhe Ministria e Financave i ka nda me atë qarkore buxhetore. Ne i kemi qarkoret dhe mundë të ju dërgojm me email secilit pasi që këto mjete nuk i ka nda Komuna, as Kryetari as Drejtori i Financave por këto mjete i ka nda Ministria e Financave në këto kategori ekonomike si paga, mallra, komunalit, subvencione, kapitale nuk mundë të ndryshohen ti bartim, ju mundë të merrni vendim por kjo nuk realizohet dhe si buxhet nuk ka me pas mundësi me u dorëzue me kohë. Edhe një informatë të investimit kapitale si kode projekte që i kemi si asfaltimi i rrugëve lokale e projekte tjera në total kështu duhet të aprovohet, nese ju tentoni të futni projekte të reja në secilin kod veç e veç unë tash po ju tregoj udhëzimin administrativ për projekte të reja është 06/2019 për projekte të reja duhet të bëhet një vlerësim kurse ne atë vlerësim tash nuk e kemi. E dim që buxheti aprovohet në shtator dhe ai buxhet duhet të bëhet së bashku me Kuvend por duhet të bëhet edhe vlerësimi ndërsa ne këtë vlerësim nuk e kemi. Nese ne tentojm të fusim projekte të reja në sistem ju informoj se nuk kalojnë pa e pasur atë vlerësim dhe ai vlerësim nuk bëhet për një ditë.

Ramush Mehmeti tha: po pajtohem plotësisht me diskutimin e Dritonit por një gjë s'po e ndryshoj pasi që kodi i kanalizimit është ne vetem projektet po i propozojm. Sa është fajtor Kuvendi që se ka aprovu

Kornizen aq është edhe ekzekutivi. E di kam pyt dhe e di se prej subvencioneve nuk mundë të barten në investime kapitale por mund të barten në komunal.

Dobrivoje Djordjevic tha: të gjithë po deklaroheni se po punoni në interes të qytetarëve, por po propozoni projekte aty ku po ju pershtatet ju e të thirrreni në emer të qytetarëve është qesharake.

Pasi nuk pati tjera diskutime kryesuesi e hudhi në votim propozim buxhetin me propozim ndryshimet e dhëna nga zv.Kryesuesi.

Me 8 vota për 5 kunder (Predrag Stojkovic, Jorgovanka Filic ,Abdyl Gashi, Jahi Zeqiri, Milica Jovanociv) 1 apstenim dhe 1 antarë nuk ishte prezent aprovohet Propozim Buxheti për vitin 2021/23 me ndryshimet e propozuara dhe biet ky:

VENDIM

Për aprovimin e buxhetit për periudhën 2021/23.

Ramush Mehmeti tha: te lista e projekteve propozoj: asfaltimin e rrugës në Koretisht 13,000€, asfaltimin i rrugës ne Tankizabel 20,000€, asfaltimin e rrugës në fshatin Kufc (Pashiq ulica) 17,000€, afaltimin e rrugës në Parallov-Golin 20,000€, afaltimi i rrugës Prekovc-Quk 10,000€, asfaltimi e rrugës Parallov-Periqi 10,000€, Asfaltimin e rrugës në Makrsh të ultë (vazhdim) 20,000€, Asfaltimi i rrugës Talaj në Llabjan (vazhdim) 4,000€, Afaltimi i rrugës në Koznic (Qeshme-Varreza) 7,000€, asfaltimi i rrugicave Dikovit Prallov 4,000€, asfaltimi i rrugës pas Xhamis Llabjan 4,000€, ndertimi i ures Brus 4,352€, ndertimi i ndriqimit publik në Pasjak(lagja e vjeter) 15,000€, ndertimi i ndriqimit publik (shkoll-degellaj-sallkaj-abazaj) ne Llabjan 10,000€, ndertimi i ndriqimit publik Talak-Haxhaj Llabjan 15,000€, ndertimi i ndriqimit publik në lagjen zenaj Tullarë 5,000€, ndertimi i kanalizimit të dikovit Parallov 7,500€, ndertimi i kanalizimit në fshatin brus 7,500€.

Sercan Todorovic tha: nuk duhet të bëjmë dyfish propozime pasi që nuk kemi shumë mjete, rrugët po ndahen si në treg po propozoni rrugë 5,000€ por ndoshta nuk mundë të realizohet as me 15,000€, për projkte se sa kushtojnë duhet të bëhet vlersimi së pari.

Kryesuesi tha: e kemi projektin e salles në Kufc janë ndar mjetet po ende nuk është perfunduar, gjithashtu janë ndar edhe disa mjete për perfundim të rrugës.

Xhejlane Behluli tha: i kemi edhe ne disa propozime por së pari para se të kalojm te propozimet si parti që e perfaqësoj, po nderlidhem me fshatin Pasjak, po pajtohem për ndriqim publik 15,000 pasi është e nevojshme shumë por fshati Pasjak është duke u rrit vazhdimisht me numer të banorëve dhe duke u zgjeruar me siperfaqe por ju mungon kanalizimi dhe rruga. Ndiqimi është i nevojshem por jo sa kanalizimi dhe rruga, andaj ju lus pasi që Pasjaki është zon kadastrale e para dhe është tatim paguese më e madhe, e kam kerkuar edhe në KPF që të na sjellet lista se cilat fshatra janë tatim paguese më shumë që të shkojn edhe projektet, nuk jeni duke vepruar drejt, ju po bisedoni vetem me qytetarët e juaj. Propozimet tona si LDK janë: asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Pasjak ka shumë nevoj 50,000€, asfaltimi i rrugës në Kufc te komuniteti shqiptar ku një pjesë është e perfunduar 30,000€ dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Makresh i ulët 50,000€.

Dobrivoje Djordjevic tha: zv.kryesuesi e ka filluar kampanjen zgjedhore, por si nuk ndajti mjete të unë asnjë. Këto propozime në vler deri 300,000€ ku do ti gjej që ti realizoj të gjitha. Mirë që u pregadit për zgjedhje por Kryetari perseri do të veproj ashtu siç do vet.

Ramush Mehmeti tha: unë kam informata se për fshatin Pasjak Ministria e Infrastruktures ka nda një shumë në vlerë prej 100,000€ për asfaltim të atyre rrugëve lokale në Pasjak. Ne kemi pasur kerkesa të qytetarëve në vlerë prej 48,000€ buxhet dhe këto i kemi nda, me pas mundësi kishem nda më shumë por kaq kemi mundësi buxhetore. Ne e dim se rruga në fshatin Makresh nuk perfundohet me 20,000€ por çdo vit ka një pjesë, pasi që këtyre qytetarëve ju është premtuar që 10 vite se do të asfaltohet rruga e ende nuk është asfaltuar.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: unë i përkrahi propozimet për investimet kapitale por shumë investime në fshatin Parallov, a është duke jetuar dikush atje?, nuk duhet anashkaluar Kufca, Pasjaki me 1000 banor e të investohet ku nuk ka banor, duhet të investohet aty ku ka banor.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: ne i kuptojmë kërkesat e qytetarëve që kanë nevojë për investime, për rrugë më shumë por mundësitë e buxhetit janë kaq sa janë. Po pajtohemi plotësisht me zv.Kryesuesin që i lexoj projektet më herët ku i kemi bërë së bashku me disa asambleista të tjerë dhe besoj se këto projekte do të zbatohen nga Kryetari i Komunës dhe ekzekutivi.

Abdyl Gashi tha: ne kemi propozuar një shumë prej 15,000€ për fshatin Pasjak, e dimë që është në kategorinë e parë si zonë por tjetra ka qenë një diskutim mes neve se për atë fshat është nda një grand prej qeverisë siç u cek edhe më herët, andaj e kemi shfrytëzuar që të kemi investime edhe në vendbanime të tjera si fshati Makresh edhe pse nuk janë shumë mjete janë pak por nuk po kemi mundësi tjetër, ne kemi ndarë edhe vitin e kaluar por ende nuk ka filluar ajo rrugë.

Xhejlane Behluli tha: e kam një kërkesë prej lagjes së re, ku është një kërkesë esenciale, rrethimi i varrezeve në lagjen e re në vlerë prej 4,000€ pasi që është rritur numri i banorëve në atë pjesë dhe është diçka esenciale. Analizoni listen nëse është mundësia me u nda një shumë prej 4,000€ mundëni edhe të dilni e të shikoni është një kërkesë esenciale, pasi që është shumë duke u rritur numri i banorëve.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesi e hudhi në votim listen e projekteve të propozuar nga Ramush Mehmeti.

Me 11 vota për, 2 përmbajtur, 1 nuk ka votuar dhe 1 nuk ishte prezent aprovohet lista me projekte e propozuara nga zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti.

Me pastaj Kryesuesi e hudhi në votim propozim buxhetin më list të projekteve.

Me 12 vota për, 1 përmbajtur, 1 nuk ka votuar dhe 1 nuk ishte prezent aprovohet buxheti 2021/23 më list të projekteve.

Pika e tretë: Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: ne në mbledhjen e kaluar kemi bërë disa mjete nga grandit i rezervës në zyrë të Kuvendit dhe pasi që Kuvendi ka mjete të mjaftueshme kërkoj që të bihet një vendim për renovimin e sallës së Kuvendit.

Zymer Zymeri tha: propozoj që të shkojmë në një vizitë jashtë vendit të mbajmë mbledhje.

Kryesuesi tha: kemi vërejtje se tavolinat në sallë janë të ngushta të papershtatshme andaj të bëjmë disa ndryshime si dhe vendosjen e kamerave që të kemi mundësi seancën ta transmetojmë live.

Kryesuesi e hudhi në votim propozimin e Ramush Mehmetit.

Me 10 vota për, 2 nuk ka votuar, 3 nuk janë prezent aprovohet ky propozim dhe bihet ky:

VENDIM

Miratohet vendimi që të bëhet renovimi i Sallës së Kuvendit Komunal të Novoobërdës, me qëllim të efektivitetit të punës më të suksesshme, në kuadër të renovimit e ku përpos renovimit dhe përshtatjes së mobilitetit të kuvendit dhe hapsirës, do të duhet të intervenohet edhe në sistemin e Teknologjisë Informative, gjegjësisht në dhenjen e mundësisë që mbledhjet e Kuvendit të mundë të përcillen On-Line në Web faqen e komunës.

Kryesuesi tha: propozimin e Zymerit të sqarohet edhe një herë për vizitë.

Ramush Mehmeti tha: është mirë pasi që kemi buxhet të mjaftueshëm të bëjmë një vizitë në Komunat tjera të socializohemi, por paraprakisht të formohet një komision që do të mirret me agjendën.

Kryesuesi e hudhi në votim propozimin për vizitë jashtë vendit.

Me 8 vota për, 3 kunder, 1 nuk ka votuar dhe 3 nuk ishin prezent aprovohet ky propozim dhe bihet ky:

VENDIM

Miratohet vendimi që të bëhet një vizitë pune jashtë vendit në lidhje me përmirësimin e efikasitetit në punët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi tha: të propozojm edhe antarët e komisionit që do të mirren me këtë vizit.

Abdyl Gashi tha: unë së pari nuk pash asnjë agjend se për çka bëhet fjalë ku do të shkojm, çfarë përvoje do të marrmi ne nese shkojm?, cila është e mira e Komunës që ja kthejm, nese organizohet vetem si erskuzion nuk është mirë që qytetarët të na shohin ne ashtu në shetitje e në tjetren anë vendi është në gjendje të mjerueshme, nese kemi ne një agjend që të shkojm dhe të këmbejm përvoja, nese vizitojm një komunë që është multietnike është në rregull.

Kryesuesi tha: sigurisht se nuk do të jetë një erskuzion por do të jetë një vizit pune.

Ramush Mehmeti tha: besoj se isha i qartë ne fillimisht po marrim vendim në mënyr që mjetet mos të shkojn suficit dhe për procedura tenderuese vetem deri në fund të muajit tetor kemi kohë, të formohet komisioni dhe ai komision do të mirret me agjenden se ku do të shkoj, vizita mundë të realizohet në tetor ose nëntor.

Dobriroje Djordjevic tha: votuat se do të shkojnë por ku do të shkojn se?.

Kryesuesi tha: do të formohet komisioni dhe do të vendosin se ku do të shkojm.

Për komision propozohet Ramush Mehmeti, Milica Jovanovic dhe Dobriroje Djordjevic.

Me 8 vota për, 6 nuk kan votuar aprovohet ky propozim për formim të komisionit dhe bihet ky:


VENDIM

FORMOHET Komisioni për vendim për vizitë me këtë përbërje : Dobriroje Djordjevic, Ramush Mehmeti, Mirjana Simijonovi.


Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:35.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



ZYRA E KRYETARIT

DATË/A:	21.09.2020
PËR/ZA/TO:	Fetije Begolli Maxhera - Udhëheqëse e Departamentit për Zhvillimit të Qëndrueshëm Komunal, Ministria e Pushtetit lokal
PËRMES/PREKO/THROGOUT NGA/OD/FROM:	g. Svetislav Ivanović - Kryetar i Komunës së Novobërdës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kerkes per shpërndarja e mjeteve

Nderuar,

Po ju drejtohem me këtë kërkesë në lidhje me përmirsimin e propozim kërkeses për shpërndarje të mjeteve për mbështetje financiare, numër 02-574 me datën 18.09.2020, ku me konsultimin me të gjithë drejtorët të Komunës së Novobërdës, kemi vendosur që duhet të ndryshojmë kërkesën e mahershme me këtë kërkesën e tashme për shpërndarjen e mjeteve financiare në lidhje me menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia.

Shpërndarja e re e mjeteve është vendosur në tabelë detajisht e shpërndarë me programet buxhetore në faqen tjetër:

Nr.	Program	Mallra e shërbime	Subvencionet dhe Transferet
1.	16030 - Zyra e Kryetarit		193,901.46 €
2.	93870 - Arsimi fillor	10,000.00 €	
3.	47030 - Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvill. rural		70,000.00 €
Total		273,901.46 €	10,000.00 €
			263,901.46 €

Bazuar në informatene pranuar shuma e synuar është në vler prej 273,901.46 € :

1. Programi buxhetor Zyra e Kryetarit (160), nënprogram Zyra e Kryetarit (16030), kodi funksional (0111), në kategorin ekonomike Subvencioneve dhe Transferimeve (200) në vlerë prej 193,901.46 €.
2. Programi buxhetor Arsimi dhe Shkenca (920), nënprogram Arsimi fillor (93870), kodi funksional (0912), në kategorin ekonomike Mallra dhe Shërbime (130) në vlerë prej 10,000.00 €.
3. Programi buxhetor Bujqësia, pylltaria dhe zhvill. rural (470), nënprogram Bujqësia (47030), kodi funksional (0421), në kategorin ekonomike Subvencioneve dhe Transferimeve (200), në vlerë prej 70,000.00 €.